VENDIM
Nr. 203, datë 10.8.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 373, SERIA T17 TË SHOQËRISË "PPC ALBANIA" SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 93, DATË 4.7.2017

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "ç" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", nenit 10, pikat 4, 5 dhe 6, dhe nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenin 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1439 prot., datë 5.8.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'PPC Albania' sh.a., me nr. 373 seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 4.7.2017",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 108, datë 19.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, të shoqërisë "PPC Albania" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 70/20 prot., datë 20.5.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 3.6.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 478/1 prot., datë 1.6.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni".

- Duke qenë se nuk u depozitua dokumentacion nga ana e shoqërisë dhe kërkesa e saj për shtyrjen e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s pa caktuar një afat për plotësimin e dokumentacionit me shkresën e protokolluar në ERE nr. 478/4 prot., datë 13.6.2022, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 160, datë 17.6.2022, vendosi të refuzojë kërkesën e shoqërisë "PPC Albania" sh.a. për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin nr. 93, datë 4.7.2017.

- Shoqërisë "PPC Albania" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 478/8 prot., datë 14.7.2022, ka depozituar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Në nenin 10, pikat 5, 6 dhe 7, "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, pavarësisht se parashikohet e drejta e aplikuesit për paraqitjen e një aplikimi të ri brenda 30 ditëve nga vendimi për mosfillimin e procedurës, dhe bazohet te neni 6, i cili nga ana e tij ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për licencim, është e qartë se në këto rrethana kjo e drejtë i njihet aplikuesit dhe në rastet kur është marrë vendimin për refuzimin e kërkesës, pasi kushti thelbësor nuk është procedura në këtë rast, por afati, pra ka të bëjë me gatishmërinë e aplikuesit për t'iu përgjigjur udhëzimeve të dhëna nga ERE brenda 30 ditëve.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 373, seria T17, të shoqërisë "PPC Albania" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 5.7.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti